



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Atdhe Arenliu BI" të datës 03.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "189 Mirëmbajtja dhe Servisimi i pajisjeve mjekësore në objektet e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-25-5129-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Atdhe Arenliu BI" të datës 03.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "189 Mirëmbajtja dhe Servisimi i pajisjeve mjekësore në objektet e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-25-5129-2-1-1 ashtu që **ANULOHE** njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Atdhe Arenliu BI" (tutje "parashtruesi") me datë 03.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "189 Mirëmbajtja dhe Servisimi i pajisjeve mjekësore në objektet e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-25-5129-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Po ashtu kemi të bashkangjitur Deklaraten e cila është nënshkruar nga themeluesit e Grupit të OE, ku citojme:

Deklarojme me përgjegjësi materiale dhe ligjore se obligohemi në grup dhe veq e veq që të kryejmë punimet (shërbimin) sipas kontratës së mundshme sikurse edhe të gjitha obligimet e tjera që rrjedhin nga kontrata.

Prandaj mbi bazën e dokumentacionit i cili është pjesë e dosjes së dorëzuar të cilat po ashtu janë të cekura më lartë, pra pasi që ekziston deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit (2 anëtarët) janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës që është në pajtim me nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik. Këto deklarata më lart mund të kenë ikur komisionit gjatë fazës së vlerësimit të ofertës tona, pra grupi i OE ka plotësuar kushtin administrativ dhe si rrjedhojë e kësaj ju lutem ta aprovoni kërkesën tonë për rishqyrtim dhe lenden ta ktheni në rivlerësim dhe këto dokumente të pranoni si valide gjatë fazës së rivlerësimit.

Parashtruesi në ofertën e tij ka dorëzuar një deklaratë për të cilën komisioni ka konstatuar se mungon në ofertë. Prandaj aktiviteti duhet të kthehet në rivlerësim në mënyrë që të shqyrtohet nëse është dorëzuar kjo deklaratë ose jo. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.09.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net